



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:064334  
Datë: 15.11.2024  
Numri i dokumentit: 06461271

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florid Hasku, me bashkëpunëtorin profesional Zef Qupi, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve Z.B. dhe Z. S. që të dyja nga Gjakova, të cilat me autorizim i përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjakovë, me objekt kontesti: kompensim i shtesës së inflacionit në pagë, jashtë seancës, me 15 nëntor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërsi kërkesëpadia e paditësve Z.B. dhe Z. S. që të dyja nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për paditësen e parë Z.B., për periudhën kohore nga data 01.02.2020 e deri me datë 21.11.2022, t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 737.95 euro, dhe paditëses së dytë Z. S. për periudhën kohore nga data 01.02.2020 e deri me datë 21.11.2022, t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 737.95 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të fillojë të llogaritet nga data 15.02.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 332.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditëset, përmes së autorizuarit të tyre, në këtë gjykatë me datën 15.02.2023, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësja e parë Z.B. është e punësuar tek e paditura në Shkollat “Rilindja” në Dobrigje, “Fan Noli” në Dujakë dhe “Emin Duraku” në Gjakovë, ndërsa paditësja e dytë Z. S. është po ashtu e punësuar tek e paditura në Shkollën

“Zekeria Rexha” në Gjakovë. Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditësve. Meqë e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim, paditëset kanë paraqitur padi përmes së cilës kanë kërkuar që t’u kompensohet diferenca e inflacionit në pagë, me kamatë ligjore si dhe i kanë kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes së autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se ky kompensim paditësve nuk iu takon as me kontratën e punës, e gjithashtu as me Ligjin e Punës. Sa i përket Kontratës Kolektive ka theksuar se e njëjta është në kundërshtim me Ligjin e Punës, pasi Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve. Tutje ka shtuar se paditësve nuk iu takon e drejta e kompensimit të inflacionit pasi në rast të shfaqjes së tij nuk godet vetëm një sektor të punësuarve si në rastin konkret sektorin e arsimit, por e godet tërë aparatit shtetëror. Ka konsideruar se në rastin konkret ka po ashtu parashkrim të kërkesës në të holla, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e themeltë dhe si e tillë tërësisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditëset të lëshuara nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësja e parë Z.B. është në marrëdhënie pune tek e paditura në Shkollat “Rilindja” në Dobrigje, “Fan Noli” në Dujakë dhe “Emin Duraku” në Gjakovë, ndërsa paditësja e dytë Z. S. është po ashtu në marrëdhënie pune tek e paditura në Shkollën “Zekeria Rexha” në Gjakovë. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë e paditësës së parë Z.B. është shuma prej 421.00 euro dhe paditësës së dytë Z. S. është po ashtu shuma prej 421.00 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura

gjkata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”.

Gjykata gjeti se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se “*Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë*”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve iu takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes së inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga viti 2020 deri në vitin 2022 (*brenda kërkesës së paditësit*) sipas përlllogaritjes si në vijim:

*Për paditëset*

- Për periudhën shkurt-dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditësve e cila në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 09.26, apo 0.84 euro për muaj ( $421.00 \cdot 0.2\% \cdot 11 = 09.26$ );
- Për periudhën janar-dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësve sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2021 do të duhej të ishte 421.84 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të

futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 172.11 euro, apo 14.34 euro për muaj ( $421.84 * 3.4\% * 12 = 172.11$ );

- Për periudhën janar-nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësve sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 436.18 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 556.57 euro, apo 50.60 euro për muaj ( $436.18 * 11.6\% * 11 = 556.57$ ).

Duke qenë se mes palëve nuk ishte kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditëset janë të punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 01.02.2020 deri me datë 21.11.2022 në pagën e paditësve nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Pretendimin tjetër të të paditurës lidhur me atë se inflacioni godet tërë aparatit shtetëror e jo vetëm sektorin e arsimit, gjykata e konsideron si të parëndësishme, për arsye se çështja e përfshirjes së inflacionit në pagën e punëtorëve të arsimit është e rregulluar me KKAK, andaj është jo relevante se nga këto kushte goditet nga shkalla e inflacionit, për aq kohë sa e drejta e

paditësve për ta kërkuar këtë kriter të kompensimit rrjedh nga dispozitat e kontratës kolektive të lartcekur.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, gjykata gjeti se ky pretendim është i pabazuar, pasi konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 15.02.2023, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre (3) viteve nga dita kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së, me ç’rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 332.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 156.00 euro si dhe për përpilimin e precizimit të padisë shumën 156.00 euro, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

2023:064334, më 15 nëntor 2024

Gj y q t a r

Florid Hasku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.